

VENDIM
Nr. 23, datë 19.2.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“PROTERGIA ENERGY ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 597/1 prot., datë 14.2.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Protergia Energy Albania’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Protergia Energy Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 597 prot., datë 7.2.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke kërkuar vijimësinë e procedurës së licencimit me procedurë të përshpejtuar, pasi kjo shoqëri (kompani bijë e “Protergia Energy” SA, me seli në Athinë të Greqisë), kërkon të regjistrohet në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX sh.a.), të themeluar në Shqipëri.

- Sa i përket kërkesës për procedurë të përshpejtuar në zbatim të nenit 37, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, sqarojmë se shoqëria nuk i plotëson këto kushte dhe ERE është e detyruar të procedojë në përputhje me dispozitat që rregullojnë procedurën e licencimit dhe nëse pas fillimit të procedurës dhe përfundimit të afatit të pritjes së komenteve, shoqëria do të ketë plotësuar të gjithë informacionin/dokumentacionin e munguar, do të ndiqet me përparësi vendimarrja përfundimtare për këtë aplikim.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat: “a”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3, gjerën “c”; si dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacioni në vijim:
NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “b”: Të depozitohen vërtetimet e gjendjes gjyqësore (dëshmitë e penaltetit), të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorët dhe vetë shoqërinë “Protergia Energy Albania” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Të depozitohet vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “b”: Të depozitohen pasqyrat financiare për kohën e krijimit të shoqërisë, si dhe dokumentacion mbështetës për vlerën e mbetur për të garantuar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën 1 (një) muaj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Protergia Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi